



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PROKURORIA PERGJITHSHME
PROKURORIA PRANE GJYKATES SE SHKALLES SE PARË
PUKË

Nr. _____ prot.

Pukë, me 09.02.2017

A N A L I Z A

**E TREGUESVE TË PUNËS SË PROKURORISË PRANË GJYKATËS SË
SHKALLËS SË PARË PUKË.
PERIUDHA : JANAR-DHJETOR 2016**

Të nderuar pjesëmarrës

Nëpërmjet këtij materiali, Prokuroria Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Pukë, ju paraqet treguesit e përgjithshëm të veprimtarisë së saj, realizuar gjatë vitit 2016, në ushtrimin e ndjekjes penale, në hetimin e çështjeve penale, përfaqësimin e akuzës para gjykatës, në fazën e ekzekutimit të vendimeve penale, si dhe ushtrimin e funksioneve dhe kryerjen e detyrave të tjera të parashikuara në ligj nga prokurorët dhe oficerët e policisë gjyqësore.

Në një vlerësim paraprak, duke marrë në konsideratë të dhënat që do të analizojmë në mënyrë të detajuar në vijim të këtij materiali, elementi i parë që evidentohet është se përgjatë vitit 2016, Prokuroria Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Pukë, ka përballuar një ngarkesë më të ulët pune krahasuar kjo me vitet e mëparshme.

Puna ne Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Pukë, gjatë vitit 2016, ka synuar ne realizimin e detyrave të saj Kushtetuese e ligjore në ushtrimin e funksioneve te ndjekjes penale në hetim, ne ngritjen dhe perfaqësimin e akuzes ne gjykate, ne ekzekutimin e vendimeve gjyqesore, si dhe detyra te tjera te parashikuara me ligj.

TË DHËNA TË PËRGJITHSHME

Në vitin 2016, Prokuroria e Rrethit Gjyqësore Pukë ka hyrë me **53 procedime** penale të mbartura në hetim nga viti 2015, me 4 persona nen hetim, me 20 te pandehur, nder te cilet 3 me mase sigurimi "arrest ne burg".

Duke parë dhe analizuar gjendjen e kriminalitetit ne tërësi, rezulton se gjate vitit 2016, situata në rrethin e Pukës, ne aspektin penal, ka patur një tendencë në drejtim të rritjes së numrit të ceshtjeve, ku për këtë vit janë rregjistruar në tërësi **281 kallezime** penale të reja. Ne raport me vitin 2015 ku jane rregjistruar 277 kallezime, pra me 4 kallezime më shum këtë vit.

Nga kallezimet e rregjistruara, **9** kallezimi jane referuar nga nenpunesit publike, **21** kallezime jane referuar nga shtetasit, **133** kallezime jane kallezime të filluar me vendngjarje, **117** kallezime jane referuar nga policia e shtetit dhe **1** kryesisht. Për tu theksuar është fakti qe mungojne referimet dhe kallezimet nga personeli mjekesor, nga policia financiare, nga policia pyjore, etj. Ku kjo ka ndodhur edhe per shkak të riorganizimit të Drejtorisë rajonale pyjore dhe drejtorive të tjera.

Gjatë vitit 2016, në lidhje me kallezimet penale të rregjistruara është vendosur për mosfillimin e hetimeve apo te procedimeve, **për 36 kallezime**, nga të cilat: 1 kallezime per nenin 76 - 22 të K.Penal per shkak se nuk ekziston fakti penal, 1 kallezime për nenin 84; 1 kallzim per nenin 89, 1 kallezime për nenin 92; 2 raste per nenin 99; 2 rast per nenin 134/1; 3 raste per nenin 150 ; 4 raste per nenin 151; 1 kallzim per nenin 186/1; 1 raste per nenin 199/a-1; 4 raste per nenin 205; 1 kallzim per nenin 242; 4 raste per nenin 248 dhe 1 raste per nenin 250; 2 raste per nenin 275, 2 kallzime per nenin 277; 2 kallzime per nenin 289/1; 3 raste per nenin 290/1 te K.Penal.

Vlen per tu theksuar fakti se pjesa kryesore e vendimeve te mosfillimit lidhet me nenet 205 e 290/1 te K.Penal. Ku rezulton se kallezimet e bera per prerjen e pyjeve ne pjesen dermuese ka rezultuar se nuk jane bërë në pyjet e mbrojtura apo ne parqet kombetare. Ndërsa ne rastet e nenit 290/1 te K.Penal, kemi te bejme me ngjarje akisdentale dhe jo me veper penale

Gjatë periudhes 01 Janar deri me 31 Dhjetor të vitit 2016, Prokuroria e Rrethit Gjyqësore Pukë, ka regjistruar **234 procedime penale te reja**, me 27 persona nen hetim, me 108 te pandehur, nder te cilet 32 të arrestuar.

Jane rifilluar hetimet per **4 procedime** penale te pezulluara dhe te pushuara.

Gjate vitit 2016 kane qene ne hetim gjithesej **291 procedime** penale me 31 persona nen hetim, me 129 të pandehur, nder te cilet 36 te arrestuar.

Gjatë periudhës 1-vjeçare për vitin 2016, jane përfunduar procedimet penale si me poshte;

Jane **pushuar 39 procedime** penale. Nga procedimet penale te pushuara rezulton se 24 procedime penale jane pushuar per mungese fakti, ndersa 6 procedime penale per mungese provash dhe 9 procedime penale jane pushuar për shkaqe te tjera.

Gjatë periudhes ne fjalë, për mosnjohje të autorit të vepres penale, **jane pezulluar hetimet për 103 procedime** penale. Nga keto 13 procedime per nenin 134, dhe 78 procedime per nenin 284 të K.Penal, si dhe per vepra te tjera penale, nga ku jane hasur probleme ne hetimin e veprave penale te vjedhjes, si dhe ne hetimin e vepres penale te kultivimit te bimeve narkotike per shkak te veshtiresive te terrenit malor dhe te perhapur te rrethit te Pukes.

Jane **transferuar gjithesej 6 procedime penale**, me 7 persona nën hetim, nga keta 6 persona te arrestuar. Nga këto procedime, pjesa me e madhe e tyre jane transferuar kryesisht per kompetencë lendore ne Prokurorine e Rrethit Gjyqesor Shkodër, ne seksionin per të mitur, etj.

Gjatë vitit 2016, janë **dërguar për gjykim 93 procedime penale** me 122 të pandehur, nder te cilet 29 me mase sigurimi "arrest ne burg". *Rezulton se numeri i procedimeve penale te derguara ne gjykim ne krahasim me vitin 2015 është me i ulet, ku ne vitin 2015 jane derguar per gjykim 106 procedime penale me 118 te pandehur, nder te cilet 20 me mase sigurimi "arrest ne burg" kjo per arsyen se ne vitin 2016 ka patur numer procedimesh me te ulet.*

Për gjithë periudhen 1-vjeçare ne fjale, jane perfunduar gjithsej **241 procedime penale** me 124 persona te pandehur, nder te cilet 35 me mase sigurimi "arrest ne burg".

Kanë mbetur në hetim te mbartura **50 procedime penale** me 13 persona nen hetim, me 5 te pandehur, nder keta 1 persona me mase sigurimi "arrest ne burg".

Nga analizimi sipas krereve të K.Penal te treguesve te mësipërm rezulton si më poshtë;

VEPRA PENALE KUNDER
PERSONIT (JETES, SHENDETIT DHE FAMILJES).

Jane mbartur nga viti i kaluar **4 procedime penale** ne hetim per veprat penale te parashikuara nga nenet 84, 88/2 e 130/a-1 të Kodit Penal, me 1 te pandehur me mase sigurimi "arrest ne burg".

Jane regjistruar për vitin 2016 gjithsej, **25 procedime penale** me 15 te pandehur, ndër të cilet 7 persona me mase sigurimi "arrest ne burg".

Për keto grup-veprash penale gjate vitit 2016 jane hetuar gjithsej **29 procedime** penale me 4 persona nen hetim, 16 te pandehur, nder te cilet 8 me mase sigurimi "arrest ne burg".

Jane pushuar **6 procedime penale**, nga te cilet per mungese fakti 2 procedime, per mungese prove 3 procedim dhe 1 procedime jane pushuar per shkaqe te tjera, per veprat penale te parashikuara nga nenet 84, 89, 99 dhe 130/a-1 te Kodit Penal.

Është **transferuar 1 procedime** penale, me 1 person nen hetim, per veprat penale te parashikuara nga neni 84 të K. Penal.

Jane derguar për **gjykim 16 procedime** penale me 16 te pandehur, nder te cilet 8 me mase sigurimi "arrest ne burg", nga këto:

- 2 procedim penale me 2 te pandehur, per nenin 84 të K.Penal;
- 1 procedim penale me 1 te pandehur me mase sigurimi "arrest ne burg" per nenin 88/2 te K.Penal;
- 1 procedim penale me 1 te pandehur per nenin 89 te K.Penal;
- 1 procedim penal me 1 te pandehur per nenin 121/a-1 te K.Penal.
- 1 procedim penal me 1 te pandehur per nenin 126 te K.Penal.
- 5 procedime penale me 5 te pandehur, 3 te arrestuar per nenin 130/a-1 te K.Penal;
- 1 procedime penale me 1 te pandehur, per nenin 130/a-2 te K.Penal;
- 4 procedime penale me 4 te pandehur, 4 te arrestuar per nenin 130/a-4 te K.Penal;

Gjithesej për periudhen ne fjalë, per keto vepra penale jane **perfunduar 23 procedime penale** me 16 persona te pandehur, nder te cilet 8 me mase sigurimi "arrest ne burg". Ka mbetur ne hetim 6 procedime penale me 2 persona nen hetim, per veprat penale te parashikuara nga nenet 84,89, 99 dhe 124/1 te K.Penal.

Duke krahasuar treguesit statistikore per keto vepra penale me vitin e kaluar, rezulton se veprat penale kunder personit kane patur te njejtet tregues ,

duke perfshire edhe veprat penale per krime kunder jetes, vrasje, apo edhe veprat me te lehta si, plagosje, kanosje, etj.

VEPRAT PENALE KUNDËR PASURISË DHE EKONOMISË

Jane mbartur nga viti i kaluar 23 **procedime** penale , me 3 persona nen hetim ,me 12 te pandehur.

Gjate vitit 2016 jane **regjistruar 51 procedime** penale me 6 persona nen hetim, me 25 te pandehur ,nder te cilet 6 persona me mase sigurimi "arrest ne burg".

Jane **rifilluar 3 procedime penale**, nga keto 2 procedime te pushuar per shkaqe te tjera dhe 1 procedim penal eshte derguar per gjykim me 1 te pandehur me mase sigurimi "arrest ne burg".

Gjithesej jane **hetuar 81 procedime** penale me 10 persona nen hetim, 40 te pandehur nga te cilet 8 mase sigurimi "arrest ne burg".

Kanë **ardhur me transferim 4 procedime** penale me 1 person nen hetim, me 2 persona te pandehur , nder te cilet 1 me mase sigurimi "arrest ne burg.

Për këto vepra penale, gjithesej jane **pushuar 14 procedime** penale. Nga këto, 12 procedime penale jane pushuar per mungese fakti, dhe 2 procedime penale për shkaqe te tjera. *Theksojme se pothuajse të gjitha procedimet penale te pushuara per mungese fakti jane per arsy se pasi jane administruar aktet e ekspertimit perkatese ka rezultuar se fakti nuk ekziston, per veprat penale kryesisht te parashikuara nga nenet 145,150, 151, etj të K.Penal.*

Për këto grup veprash penale, jane pezulluar hetimet per **18 procedime** penale per mosnjohje te autorit te vepres penale ku pjesa me e madhe e ketyre procedimeve te pezulluara jane per veprat penale te parashikuara nga nenet 134 (13 *procedime*), 150 (2 *procedime*), 151 (3 *procedime*) të K.Penal.

Është transferuar per kompetence lëndore dhe territoriale në Prokurorite e tjera, 1 procedime penale, me 2 te pandehur me mase sigurimi "arrest ne burg" per vepren penale te parashikuar nga neni 134/2 i K.Penal;

Për këtë seksion veprash penale, jane derguar për **gjykim 34 procedime** penale me 36 te pandehur, ndër të cilet 5 me mase sigurimi "arrest ne burg". Jane derguar per gjykim 2 procedime penale per veprat penale te parashikuar nga neni 134/1, 2 me 3 te pandehur nder te cilet 2 me mase sigurimi "arrest ne burg"; - 9 procedime per nenin 137/1,2 me 9 te pandehur nder te cilet 1 me

mase sigurimi "arrest ne burg"; -1 procedim per nenin 143/1 me 3 te pandehur; - 14 procedime per nenin 145; - 1 procedim per nenin 180/1; - 5 procedime per nenin 186/1,2 me 4 te pandehur nder te cilet 2 me mase sigurimi "arrest ne burg"; - 1 procedime per nenin 187 dhe -1 procedim penal per nenin 199/a-1 te K.Penal.

Për periudhen ne fjale janë përfunduar gjithesej **67 procedime** penale me me 38 te pandehur nga te cilet 7 të arrestuar.

Jane mbartur në hetim per vitin ne vazhdim **14 procedime** penale me 6 persona nen hetim.

Nga treguesit e mesiperm krahasuar me vitin e kaluar rezulton se ka pasur nje renie te procedimeve penale te regjistruara per veprat penale kunder pasurise dhe ekonomise.

VEPRAT PENALE KUNDER MJEDISIT.

Nga viti i kaluar nuk ka pasur procedime penal te mbartura per kete grup veprash penale.

Gjate vitit 2016, jane rregjistruar **6 procedime** penal, -2 procedime penale per nenin 205 dhe 4 procedime penale per nenin 206/a-1 i K.Penal.

Nga këto procedime penale, 3 procedim penal jane pushuar per munges fakti , ndersa 1 procedim penal eshte pezulluar per mosnjohje te autorit te vepres penale.

VEPRAT PENALE KUNDER AUTORITETIT TE SHKETIT.

Janë mbartur nga viti i kaluar **26 procedime** penale me 7 persona te pandehur, nder te cilet 2 te arrestuar.

Gjate vitit 2016, jane **regjistruar 145 procedime** penale me 14 persona nen hetim, 64 te pandehur, nder te cilet 18 të arrestuar.

Ështe rifilluar nga pushimet 1 procedim penal .

Nga këto vepra penale per vitin 2016 jane hetuar gjithesej **172 procedime** penale me 14 persona nen hetim, 71 te pandehur, nder te cilet 20 të arrestuar.

Gjatë periudhes ne fjale, jane **pushuar hetimet per 15 procedime** penale. Nga këto, 6 procedime penale jane pushuar mungese fakti, 3 procedime per mungese provash dhe 6 procedime per shkaqe te tjera. Nga këto, 1 procedim për nenin 238, 3 procedime per nenin 248, 5 procedim per nenin 275(kryesisht

per shkak te terheqjes se ankimit nga i demtuari), 1 procedime per nenin 277, 1 procedim per nenin 278/2, 1 procedim per nenin 282/2. 1 procedim per nenin 284/1, 1 procedim per nenin 289/1 dhe 1 procedim per nenin 290/1 te K.Penal.

Jane pezulluar hetimet per mosnjohje te autoresise se veprave penale per **83 procedime** penale. Numrin më të madh nga keto procedime penale te pezulluara e ze vepra penale e kultivimit te bimeve narkotike neni 284/1 dhe konkretisht 78 procedime penale dhe 3 procedim per nenin 284/2 dhe 2 procedime per nenin 278/3,4 të K.Penal.

Eshte transferuar ne nje Prokurori tjetër **4 procedim** penal me 6 persona nen hetim me 4 me mase sigurimi "arrest ne burg".

Jane derguar per **grykim 41 procedime** penale me 68 te pandehur nga të cilët 16 me mase sigurimi "arrest në burg".

Nga të dhenat statistikore rezulton se jane perfunduar gjithesej **143 procedime penale** me 68 te pandehur ndër të cilet 20 me mase sigurimi "arrest ne burg".

Kane mbetur **ne hetim 29 procedime** penale me 5 persona nen hetim, 3 te pandehur nder keta 2 te arrestuar. Nje pjese e madhe e këtyre procedimeve penale jane regjistruar ne periudhen e fundvitit dhe jane per veprat penale te parashikuara nga nenet 238, 248, 275, 283, etj, te K.Penal, ndersa pjesen me te madhe rreth 8 procedime jane per nenin 284/1,2 te K.Penal, per te cilen kane ndikuar vonesat ne berjen dhe administrimin e akteve te ekspertimeve kimike.

Nga treguesit statistikor te mesiperem krahasuar me vitin e kaluar rezulton se ka nje rritje te procedimeve penale te rregjistruara per keto vepra penale.

VEPRAT PENALE KUNDËR DREJTESISË.

Nuk jane mbartur nga viti i kaluar asnje procedim penal.

Gjate vitit 2016, është **rregjistruar 1 procedime** penale, me 1 te pandehur, per nenin 305 te K.Penal.

Ardhur me **transferim 1 procedim penal** me 1 te pandehur.

Nga këto vepra penale per vitin 2016, jane hetuar gjithesej 2 procedime penale me 2 te pandehur.

Gjate periudhes ne fjale nuk ka pasur çeshtje te pushuara per kete grup veprash penale.

Gjate periudhes ne fjale nuk ka pasur çeshtje te pezulluara per kete grup veprash penale dhe gjithashtu nuk ka pasur procedime te transferuara.

Jane dërguar per **gjykim 2 procedime** penale me 2 te pandehur, dy procedime per nenin 305 te K.Penal.

Nuk ka procedime penale te mbartura ne hetim per kete seksion veprash penale.

Nga të dhenat statistikore, rezulton se krahasuar me vitin e kaluar ka pasur renie te procedimeve penale te rregjistruara per keto vepra penale.

VEPRAT PENALE QE LIDHEN ME ZGJEDHJET

Nuk jane mbartur nga viti i kaluar asnje procedim penal.

Gjate vitit 2016, është **rregjistruar 1 procedime** penale per vepren penale te parashikuar nga neni 328 i K.Penali, procedim i cili eshte mbartuar ne hetim.

- TREGUESIT STATISTIKOR TË PËRFAQESIMIT TË AKUZES NE GJYKATË NGA PROKURORET E PROKURORISË PUKË, PËR PERIUDHËN 01 JANAR - 31 DHJETOR TE VITIT 2016, JANE SI ME POSHTE :

Nga çështjet e perfunduara jane derguar në **gjykim 93 procedime** penale me 122 te pandehur, nga te cilet 29 te arrestuar. Ku krahasuar me nje vit me pare rezulton se ka renjie te numer të ceshtejeve te derguara ne gjykim, (106 *procedime ne vitin 2015*), per shkak te numerit me te ulet te rregjistrimit te procedimeve penale per vitin 2016..

Rezulton se jane mbartur ne **gjykim 38 çështje penale**. Gjithsej kane qene ne gjykim 131 procedime, me 174 te pandehur, nder te cilet 42 me mase sigurimi "arrest ne burg".

Gjithsej jane gjykuar gjatë këtij viti 93 çeshtje, me 110 te pandehur nga te cilet 29 me mase sigurimi arrest ne burg.

Gjatë vitit 2016, jane gjykuar me proceduren e gjykimit te zakonshem **32 ceshtje**. - Me gjykim te **shkurtuar 51 çeshtje**, **6 çeshtje** jane gjykuar ne mungese te te **pandehurve** dhe **4 ceshtje** jane gjykuar me **proceduren e gjykimit te drejtperdrejte**. Numeri i ulet i çeshtjeve te gjykuara me *proceduren e*

gjykimit te drejtperdrejte eshte per shkak te veshtiresive ne mbledhjen e provave, por krahsuar me vitin e kaluar eshte ne rritje.

Nga treguesit statistikor rezulton se nga ana e prokurorise eshte kerkuar denimi me **gjobë ne 19 raste**, eshte kerkuar denim **minimal ne 3 rast**, eshte kerkuar denim **mesatar 56 raste** dhe ne **6 raste** eshte kerkuar denim ne maksimum. Ështe kerkuar pezullimi i denimit bazuar ne nenin 59 te K.Penal në **25 raste**. Gjithashtu nuk eshte kerkuar pushimi i çështjes ne asnej rast.

Nga ana e Gjykatës janë dhene dënime me **gjobe në 22 raste**, është dhene denim ne **minimum në 5 raste**, eshte dhene denim **mesatar në 36 raste**. Ndërsa ne **34 raste** është aplikuar pezullimi i dënimit sipas nenit 59 te K.Penal. Në **4 raste** eshte vendosur **pushimi i ceshtjes** (kryesisht për terheqje ankimi) dhe në 5 raste është dhënë pafajësi, dhe 1 rast pushim çeshtje.

Gjithsej ka përfunduar gjykimi per 93 procedime penale me 110 te pandehur nga te cilet 29 te arrestuar. Vazhdon gjykimi per 38 procedime me 64 te pandehur nga te cilet 13te arrestuar.

Në lidhje me kerkesat tona per llojin dhe masen e denimeve, dënimet me gjobe jane kerkuar ne ato raste kur eshte vleresuar rrezikshmeria e vogel e veprave penale dhe e autoreve te tyre si dhe ne ato raste kur dispozita ka parashikuar vetem kete lloj denimi. Konkretisht, ky lloj denimi është kerkuar nga ana jone per veprat penale 237, 242, 274 , 277 etj. Denimi me burgim ne minimum si dhe denim me kusht eshte kerkuar ne nje numer te veprave penale me rrezikshmeri te vogel ose per shkak te personalitetit te pandehurit si per nenet 84, 121/a-1, 130/a-1, 145 (ne rastet e mashtrimit me dosjet e pensioneve) etj. Gjithashtu jane marre parasysh rrethanat lehtesuese, kohen relativisht te gjate te kryerjes se vepres penale, moshen e te denuarit, pendimin e shfaqur si dhe vleren e vogel te demit te shkaktuar nga i pandehuri, etj.

Ndërsa nga ana jone eshte ndjekur nje politike e ashper denimi ndaj te pandehurve qe kane kryer vepra penale kunder personit, jetes dhe shendetit, si; plagosje te renda, per veprat penale kunder pasurise si ato te vjedhjes, te dhunes ne familje, etj. Nje qendrim relativisht i ashper eshte mbajtur per veprat penale qe kane cenuar rendin dhe sigurine publike si, ato te mbajtjes pa leje te armeve luftarake sidomos ne ato raste kur armet jane mbajtur ne vende publike apo kur i pandehuri ka kanosur me arme apo ka kryer veper tjeter. Po ashtu, nje qendrim i ashper ne kerkesat tona per llojin dhe masen e denimit eshte mbajtur edhe ne veprat penale te prodhimit dhe shitjes se narkotikeve. Kerkesat

tona per denime me burgim drejt maksimumit te saksionit jane bere per veprat penale te renda, 88/2 , 284/2 të K.Penal, etj.

Janë apelur vendimet e Gjykatës, nga ana e Prokurorise per 32 çeshtje, për masa denimi, për pafajesi, si dhe apelime kundërshtuese ndaj ankimeve të pandehurve dhe pales mbrojtese të të pandehurit. Nga këto, nje pjese e konsiderueshme jane pranuar nga Gjykata e Apelit ose eshte mbeshtetur ankimi i prokurorit per masat e denimit, ndersa ne rastet e tjera çeshtjet jane ne gjykim.

Në lidhje me pafajsitë rezulton si me poshte:

- 1 rast per nenin 186/1 e 277 të K.Penal, Gjykata e Pukes ka dhene pafajsi dhe eshte ushtruar ankim ne Gjykatën e Apelit Shkoder, dhe gjykata ka vendosur lenien ne fuqi te vendimit te pafajesise, per te cilin eshte ushtruar rekurs ne Gjykatën e larte.
 - 3 raste per nenin 145 te K.Penal, Gjykata e Pukes ka dhene 2 pafajsi dhe 1 pushim e çeshtjes eshte ushtruar ankim ne Gjykatën e Apelit Shkodër dhe nuk jane marre akoma vendimet e formes se prere.
 - 1 çeshtje per nenin 277 të K.Penal, Gjykata e Pukes ka dhene pafajsi dhe eshte ushtruar ankim ne Gjykatën e Apelit Shkoder dhe nuk eshte marre akoma nje vendim i formes se prere.
 - 1 çeshtje per nenin 278/2 e 84 të K.Penal, Gjykata e Pukes ka dhene pafajsi dhe eshte ushtruar ankim ne Gjykatën e Apelit Shkoder dhe nuk eshte marre akoma nje vendim i formes se prere.
- Jane ankimuar në Gjykatë, nga subjektet e interesuara, 2 vendime pushimi te procedimit penal, ku ne 2 raste gjykata ka vendosur rrezimin e ankimit dhe lenien ne fuqi te vendimit te pushimit. Ndaj ketij vendimi eshte ushtruar ankim dhe Gjykata e Apelit Shkoder, por akoma nuk e ka marre ne shqyrtim.*
- Jane ankimuar ne Gjykate, 2 vendime per mosfillimin e procedimit penal, ku ne 2 raste gjykata ka vendosur rrezimin e ankimit dhe lenien ne fuqi te vendimit te mosfillimit, ku ndaj ketij vendimi eshte ushtruar ankim dhe Gjykata e Apelit Shkoder por akoma nuk e ka marre ne shqyrtim.*

- EVIDENCAT STATISTIKORE TË ARRESTIMEVE, NDALIMEVE DHE MASAVE TE SIGURIMIT TË KERKUARA DHE VENDOSURA NDAJ TE PANDEHUREVE PER PERIUDHEN 01 JANAR-31 DHJETOR 2016.

Gjate vitit 2016, jane arrestuar në flagrancë nga policia gjyqesore 34 te pandehur dhe jane ndaluar me inisiative 4 te pandehur, ne 3 raste është leshuar urdher ndalimi nga Prokurori. Nuk ka pasur raste nga Prokuroria që të kete urdheruar lirim e menjëhershëm te të arrestuarve apo ndaluarve. Në total jane arrestuar dhe/ose ndaluar 41 të pandehur.

Jane kërkuar vleftësimet si të ligjshme, për 41 arrestime dhe ndalime te bera nga policia gjyqesore. Në 35 raste gjykata ka vendosur vleftesimin si ligjshem te arrestimeve dhe ndalimeve. Ndersa ne 6 rast ka vleresuar të paligjshem te arrestit te bere nga policia gjyqesore.

Është kerkuar nga Prokuroria per 33 te arrestuar masa e sigurimit “arrest ne burg”, per 5 te arrestuar është kerkuar masa e sigurimit “arrest ne shtepi” dhe per 3 te arrestuar eshte kerkuar masa e sigurimit “detyrim per paraqitje ne policine gjyqesore”. Gjithesej jane kerkuar masa shtrenguese per 41te arrestuar.

Gjykata ne lidhje me kerkesat e Prokurorise, ka vendosur per 25 te arrestuar masen e sigurimit “arrest ne burg”, per 5 te arrestuar eshte vendosur “arrest ne shtepi”, per 1 te arrestuar “arrest ne burg me afat”, per 10 te arrestuar eshte vendosur masa “Detyrim per paraqitje”.

Jane dhene gjithesej 41 masa shtrenguese. Jane apeluar nga Prokuroria masat per 4 te arrestuar, ku eshte kerkuar arrest ne burg dhe nga gjykata ne nje rast ka pranuar kerkesen per caktimin e mases arrest ne burg dhe ne nje rast eshte lene ne fuqi vendimi i gjykates per masen detyrim paraqitje, per nenet 248 të K.Penal. Ndërsa nga ana e te arrestuarve është bërë ankim ne 5 raste. Gjithesej jane apeluar 9 masa sigurimi.

Duhet theksuar se Gjykata ka vendosur ne raport me kerkesat e Prokuroreve per masat e sigurimit te kerkuar persa i perket veprave penale te renda si ato kunder personit, vjedhjes se pasurise, per veprat penale qe kane cenuar rendin dhe qetesine publike, mbajtjes pa leje te armeve luftarake, prodhimit dhe shitjes se narkotikeve, etj.

Gjate vitit 2016 nuk kemi pasur kerkesa per masa te sigurimit per veprat penale te korrupsionit, pastrimit te parave dhe vepra ne fushen e tatimeve.

Gjithashtu nga ana e prokurorise nuk eshte kerkuar caktimi i masave te sigurimit Garanci pasurore dhe Ndalimi i qendrimit ne nje vend te caktuar te parashikuara nga nenet 235, 236 të K.Pr.Penale, pasi nuk jane evidentuar plotesimi i kriterëve per keto masa dhe gjithashtu, ato nuk jane aplikuar ne asnje rast nga gjykata.

- TREGUESIT STATISTIKORE TË EKZEKUTIMIT TË VENDIMEVE PENALE GJATE PERIUDHES NJE VJEÇARE PER VITIN 2016.

Në lidhje me ekzekutimet jane nxjerre urdherat e ekzekutimit brenda afatit ligjor për të gjitha vendimet e formes se prere te ardhura ne Prokurori.

Kane gene të mbartura nga viti 2015 si te paekzekutuara **vendimet penale per 27 te denuar**, 2 te denuar me burgim të perjetshem, 19 te denuar me burgim, 1 i denuar me gjobe dhe 5 te denuar me denime alternative.

Gjate vitit 2016, jane nxjerre nga Prokuroria e Rrethit Gjyqesor Pukë, urdherat e ekzekutimit te vendimeve penale per 50 të dënuar, 15 te denuar me burgim, 20 te denuar me gjobë. Gjithashtu jane nxjerre edhe 15 urdhera per denime alternative, te cilet jane vene te gjithë ne ekzekutim.

Gjate vitit 2016 rezulton te jene ekzekutuar plotesisht vendimet penale per 1 te denuar me burgim, si dhe 4 per te denuarit me gjobe dhe 3 te denuarit me denime alternative.

Kane mbetur te paekzekutuara vendimet penale per 14te denuar me burgim dhe per 16te denuar me gjobe dhe 12 te denuar me denime alternative.

Për sa i perket ekzekutimit te vendimeve penale per te denuarit me burgim ne mungese dhe me gjobe theksojme se ka permiresime ne krahasim me vitet e meparshme.

Nga ana e Prokurorise se Rrethit Gjyqesor Pukë rezulton se per vitin 2016, nuk ka patur asnje kerkesa per ekzekutimin e leterporosive per jashte shteti. Ndersa nuk ka pasur kerkesa per ekzekutim leterporosie te ardhura nga jashte shteti.

Duke i marre ne pergjithesi, treguesit statistikore te ndjekjes penale per vitin 2016, rezulton se jane regjistruar nje numer procedimesh me i vogel se ne vitin 2015. Numrin me te madh te procedimeve penale, e zene veprat penale kunder pasurise (vjedhje te ndryshme) Vjedhjet e energjise elektrike, mashtrimet ne sigurime, dhe ekonomise dhe pas tyre jane veprat penale kunder autoritetit te shtetit. Në pergjithesi verehet se ka nje tendence të pergjithshme

në uljen e numrit të veprave penale, ne seksionet e ndryshme te veprave penale, ne krahasim me vitin e kaluar.

Per sa i perket treguesve statistikor ne hetimet paraprake dhe ne gjykim vlen te theksojme se ka nje rritje te cilesise dhe shpejtesise se punes ne hetimin e ceshtjeve penale. Kjo duke pare se pjesa me e madhe e procedimeve jane kryer brenda afatit tre-mujor dhe vetem ne pak raste ka patur zgjatje te afateve, ndryshim kualifikimi te veprave penale dhe nuk ka pasur vendime per pavlefshmeri të akteve nga ana e gjykatës. Në rritjen e shpejtesise dhe cilesise se hetimit te veprave penale dhe perfaqesimit te akuzes ne gjykim ka ndikuar numri i prokuroreve prane Prokurorise Pukë.

Në lidhje me **zgjatjen e afateve** te hetimeve eshte vendosur zgjatje afatesh deri ne tre muaj në 7 procedime penale me 10 te pandehur, nga keta 5 të arrestuar. Ndersa ka pasur zgjatje të metejshme te afateve hetimore 1procedim penal me 1 te arrestuar (neni 284 i K.Penal).

Duhet theksuar se zgjatjet kane qene te lidhura me numrin e procedimeve ne hetim, per shkak te vonesave ne ardhjen e akteve te ekspertimeve, tabulateve te numrave telefonike te kerkuar kompanive celulare,te pergjigjeve te institucioneve te ndryshme, si per pergjigjet nga institucionet e tjera shteterore qendrore dhe vendore,etj. Procedimet e mesiperme jane hetuar kryesisht nga tre prokuror, dhe nje oficer i sherbimit te policise gjyqesore, gjithashtu zgjatjet jane ndikuar edhe nga ndryshimet e shpeshte te oficerëve te ngarkuar me hetimin e procedimeve ne fjale.

Roli i Prokuroreve ne raport me policine gjyqesore ka qene aktiv dhe efektiv gjate hetimeve paraprake. Një vemendje e veçante eshte kushtuar edhe ne kryerjen e veprimeve te para hetimore ne vendngjarje, veçanerisht ne ato te veprave penale kunder personit, shkeljes se rregullave te qarkullimit rrugor, apo ne vepra te tjera te renda, ku pjesemarraja e prokurorit ka qene efektive, ne drejtimin e hetimeve dhe orientimin e oficerëve ne kryerjen e veprimeve te duhura hetimore.

- PËR SA I PËRKET VOLUMIT TË PUNES SË PROKURORËVE DHE OFICEREVE TREGUESIT JANE SI MË POSHTË :

Nga Drejtuesi i Prokurorise Elidjana Kasa, jane marre ne hetim gjithesej 147 materiale hetimore, nga keto materiale eshte vendosur mosfillimi për 12 kallezime penale dhe jane hetuar 135 procedime, jane pushuar 13

procedime penale, jane pezulluar 55 procedime penale, jane transferuar 1 procedime penale, jane derguar ne gjyq 38 procedime penale, ka mbrojtur akuzen ne gjykate per 38 procedime penale. Jane mbartur ne hetim 12 procedime penale. Theksojme se nje pjese e madhe e procedimeve penale te pezulluara jane per veprat penale te parashikuara nga neni 284 i K.Penal.

Nga Prokurori Ardian Nezha, jane marre ne hetim gjithesej 131 materiale hetimore, nga keto materiale eshte vendosur mosfillimi per 17 kallelzime penale dhe jane hetuar 122 procedime, jane pushuar 14 procedime penale, jane pezulluar 27 procedime penale, jane transferuar 2 procedime penale, jane derguar ne gjyq 40 procedime penale. Jane mbartur ne hetim 38 procedime penale

Nga Prokurori Gezim Çopa, jane marre ne hetim gjithesej 64 materiale hetimore, nga keto materiale eshte vendosur mosfillimi per 15 kallelzime penale dhe jane hetuar 49 procedime, , jane pushuar 12 procedime penale, jane pezulluar 19 procedime penale, jane transferuar 3 procedime penale, jane derguar ne gjyq 15 procedime penale.

Nga ana e prokuroreve jane perfaqesuar edhe nje numer i konsiderueshem i ceshtejeve penale te paraqitura ne gjykate bazuar ne nenin 59 te K.Pr.Penale dhe gjithashtu edhe ne ceshtje civile, ne te cilat parashikohet nga ligji pjesemarrja e prokurorit (Heqje apo kufizim i zotesise per te vepruar, etj).

Në Prokurorine e Rrethit Gjyqesor Pukë ka pasur vetem nje oficer te policise gjyqesore, oficeri Hasan Hasani i cili ka pasur ne hetim te gjitha ceshtjet e filluara ne prokurori ne baze te kallelzimeve te shtetasve apo institucioneve publike.

Nga oficeri Hasan Hasani jane marre 22 procedime te mbartura nga viti 2015 dhe 50 procedime te filluara gjate vitit 2016, gjithsej 72 procedime penale. Nga keto procedime 51 procedime jane perfunduar me relacionin perkates duke sugjeruar edhe menyren e perfundimit te ceshtjes, ndersa 21 procedime jane mbartur ne vitin 2017.

Për sa i perket ngarkeses se punës Prokurorëve dhe Oficereve te Policise Gjyqesore si dhe Oficereve te Sherbimeve te Policise Gjyqesore procedimet penale jane ndare ne menyre te drejte duke patur parasysh veshtiresine dhe volumin e punes se tyre, kompleksitetin e tyre dhe rendesine e veprave penale te hetuara nga sejcili Prokuror apo oficer i policise gjyqesore.

Gjatë periudhes 1-vjeçare nga Prokurori i Rrethit Gjyqësor Pukë, nuk ka pasur raste të shfuqizimit të vendimeve të Prokuroreve ose ushtrimi i apelimeve për vendime të themelit, ku është përfaqësuar akuza nga Prokurorët e kësaj Prokurorie. Përsa i përket stafit, në përgjithësi është kërkuar një zbatim më korrektësi i disiplinës në punë dhe etikës së tyre gjatë ushtrimit të detyrës. Vihet në dukje se stafi administrativ i kësaj prokurorie është relativisht i vogël, çka ka ndikuar dhe vështirësuar perfundimin e akteve dhe ushtrimin e detyrave të ndryshme procedurale dhe administrative në një kohë sa më të shpejtë.

Gjithashtu, në lidhje me urdherat dhe udhëzimet e Prokurorit të Përgjithshëm të ardhura në Prokurori, janë njohur të gjithë punonjësit, konkretisht Prokurorët dhe Oficerët e Policisë Gjyqësore dhe administrata.

Për sa i përket pagesës së gadishmerisë dhe të oreve të kryera mbi kohën normale, për Prokurorët, Oficerët e Policisë Gjyqësore këto janë përlogaritur sipas një grafiku mujor të shërbimit të gadishmerisë, miratuar nga drejtuesi i prokurorisë, ndërsa për punonjësit e administratës është bërë mbi bazën e përlogaritjes për daljen në punë mbi kohën normale të punës.

Për sa i përket marrëdhënieve me Drejtues të Institucioneve të tjera si:

- Me Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pukë, marrëdhëniet kanë qenë të mira, korrekte dhe institucionale, është kërkuar rritja e bashkëpunimit në drejtim të përmirësimit në lidhje me shpejtesinë e gjyqimit të procedimeve penale, administrimit të vendimeve të masave të sigurisë dhe atyre të formës prapë në lidhje me ekzekutimin e tyre, etj.
- Me Drejtorinë e Policisë së Qarkut Shkodër dhe Komisaratin e Policisë Pukë, marrëdhëniet kanë qenë shumë të mira, të kënaqshme, rezultojnë se ka pasur rritje të bashkëpunimit mes dy institucioneve në drejtim të rritjes së cilësive dhe shpejtesive së hetimit të kallezimeve dhe procedimeve penale. Problemi shqetësues vazhdon të jetë mungesa e oficerëve të seksioneve, levizja e tyre e shpeshtë, transferimi, zëvendësimi i tyre, mungesa e përvojës në fushën e ndryshme të hetimit dhe veprat e reja, që kanë ndikuar në cilësinë e hetimit, shpejtesinë dhe në përzullimin dhe pushimin e një numri të konsiderueshëm të procedimeve penale.
- Me zyren e Përmbarimit Pukë, marrëdhëniet kanë qenë shumë të mira, është bashkëpunuar në vazhdimësi në lidhje me ekzekutimin e vendimeve të denimit me gjobë dhe shpenzimeve gjyqësore.

- Me Zyren e Sherbimit te Proves Pukë, e cila eshte nje zyre e re e krijuar ne rrethin e Pukes, marredheniet me kete institucion kane qene shume te mira, eshte rritur bashkepunimi dhe eficenca si rrjedhoje e afersise se saj me vendbanimin e te denuarve. Gjithashtu, ka nje permirsim ne lidhje me njoftimin dhe paraqitjen e te denuarve me kusht dhe ekzekutimin e ketyre denimeve alternative.
- Me institucionet e pushtetit lokal, si N/prefekturen, Bashkite, Njesia Administrative dhe drejtorite lokale, dhe institucionet e tjera, marredheniet kane qene korrekte, te mira, por vleresojme se ka vend per me shume bashkepunim dhe eficencë.

Problematikat e punes ne vitin 2016, ka konsistuar kryesisht, por jo vetem;

1. Në numrin e vogël të oficerëve ne Prokurorine Pukë, ne verifikimin dhe hetimin e çështjeve penale ;
2. Numrin e paket dhe levizjen e shpeshte dhe problematike te oficerëve te policise gjyqesore te Komisariatit Puke dhe Drejtorise se Policise Shkoder, qe ka shkaktuar vonesa ne hetim, zgjatjen e tyre si pasoje e zevendesimin e oficerëve, si dhe tranferimi i menjehershëm oficerëve pa njoftuar Prokurorine, kur oficeri ka pasur ne hetim nje numer te konsiderueshem te procedimeve, procedime komplekse apo edhe ne perfundim te afateve .
3. Niveli dhe profesionalizmi i nje pjese te oficerëve te policise gjyqesore nuk eshte i kenaqshem, ku rezulton se oficeret nuk kane aftesite dhe eksperincen e duhur ne fusha te ndryshme te hetimit, fakt ky qe ka ndikuar ne menyre te drejteperdrejte ne cilesine e hetimeve.
4. Ardhja me shume vonese e akteve te ekspertimeve te ndryshme, sidomos nga D.P.SH Tirane, riekspertimet, ardhja me vonese e tabelave fotografike te kqyerjeve, vonesat ne pergjigjet e tabulateve te kompanive telefonike, deshmitet e penaltetit kane ndikuar drejteperdrejte ne cilesine dhe kahezgjatjen e hetimeve.
5. Mungesa e eksperteve te ndryshem dhe perkthyesve ne rrethin e Pukes, per kryerjen e ekspertimeve te ndryshme ligjore, perkthimeve, etj dhe vonesat ne gjetjen dhe kryerjen e ekspertimeve nga ekspertetet jashte rrethit, kane ndikuar ne afatet e hetimit, etj...
6. Ne vitin 2016 per Prokurorine Puke na jane vene ne dispozicion fondet si me poshte :

Ne zerin 600, ku perfshihen pagat e punonjesve kemi patur ne dispozicion 10.007.000 leke, nga kjo shume i jane kaluar ne dispozicion

te Prokurorisë së Përgjithshme Tiranë 1.760.000 leke, kjo për faktin se në periudhat kohore të ndryshme gjatë vitit 2016 kemi patur mungesa në organik, ndërsa me shuma prej 8.247.000 leke janë bërë pagesat e punonjësve .

Në zërin 601, që përfaqëson pagesat për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore të punonjësve të kësaj Prokurorie, kemi patur në dispozicion 1.231.000 leke, shumë kjo e shpenzuar plotësisht.

Në zërin 602, që përfaqëson të gjitha shpenzimet operative të institucionit, si dhe pagesat e ekspertëve dhe të avokateve për vitin 2016, kemi patur në dispozicion shumën prej 1.510.000 leke. Pagesat për shërbimet e ndryshme janë bërë sipas rregullave në kohën e duhur, nga ku ka rezultuar se nuk kemi mbartur në vitin 2017 asnjë faturë financiare, apo shpenzime për pagesat e ekspertëve dhe të avokateve të pa paguara nga viti 2016, duke përjashtuar vetëm fatura të shërbimit për muajin Dhjetor 2016 ku pasi na janë vënë në dispozicion në muajin Janar 2017 është bërë edhe likuidimi i tyre.

Në fillim të vitit 2016, kemi patur plan për shtesë objekti (tek godina e Prokurorisë) dhe rikonstruksion të godinës shumën prej 6.424.000 leke, si dhe për blerje paisje e orëdi për zyrat shumën prej 832.000 leke, ku me pas janë tërhequr nga Prokuroria e Përgjithshme Tiranë.

Problemi shqetësues kemi lidhur me gjendjen e arkivës që ndodhet tek godina e Prokurorisë së rrethit Gjyqësor Pukë , ku për mungesë ambientimi kemi vënë në veshitësi për arshivimin e dosjeve dhe të provave materiale, pasi nuk kemi ambient tjetër, ku për këto arsye kemi bërë kërkesë çdo vit për shtesë objekti, gjë e cila në vlerësimin tonë është e domosdoshme.

Per sa i perket vitit 2017, prioritetet kryesore të punës sone do të përqendrohen në përfundimin sa më shpejt të procedimeve të mbartura nga viti i kaluar brenda afatit të hetimeve.

Një kujdes më i madh duhet kushtuar në mbikqyerjen e ekzekutimit të vendimeve penale si ato me burgim dhe gjore.

Prioriteti i punës tone përveç të tjerave gjatë vitit 2017, do të jetë:

- Rritja e efektivitetit të punës dhe ndjekjes penale për vepra penale të krimit ekonomik dhe korrupsionit, trafikëve të paligjshme, prodhimit

- dhe shitjes se narkotikeve, kultivimit te lendeve narkotike si dhe per veprat penale te tjera te renda, si vrasje, vjedhje me arme apo me dhune, shkelje e rregullave te qarkullimit rrugor, etj.
- Rritja e cilesise se hetimit, duke ulur ne maksimum rastet e pafajesive dhe pushimit te çeshtjeve, e veçanerisht ato me te arrestuar;
- Përfundimin e hetimeve brenda afatit 3 mujor;
- Uljen e metejshem te procedimeve te pushuara ne pergjithesi, por sidomos ato per mungese provash;
- Uljen e numrit te procedimeve te pezulluara;
- Rritjen e numrit te procedimeve penale te ekzekutuara;
- Rritjen e kontrollit dhe disiplines ndaj oficerëve te policise gjyqesore ne zbatimin e legjislacionit penal dhe procedural penal, evidentimin e shkeljeve te kryera duke nxjerre edhe pergjegjesite perkatese.

Duke ju falenderuar te gjithe te pranishmit, për pjesemarrjen dhe mirekuptimin, në paraqitjen e analizes së Prokurorisë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Pukë, për vitin 2016. Urojmë të arrijmë nje nivel më të lartë dhe suksese të përbashketa, per vitin 2017.

Pukë, me 09 .02.2016.

DREJTUESI I PROKURORISË

ELIDJANA KASA

KRIME KUNDËR JETËS ME DASHJE	2015					2016				
	Nr. Procd. Regj	Nr. procd per gjykim	Nr. i pand. Regj.	Nr. Pand. Per gjykim	Nr. Pand denuar	Nr. Procd. Regj	Nr. procd per gjykim	Nr. i pand. Regj. ¹	Nr. Pand. Per gjykim	Nr. Pand denuar
Neni 76 Vrasja:										
Neni 77 Vrasja për një krim tjetër										
Neni 78 Vrasja me paramendim										
Neni 78/a Vrasje per gjakmarrje										
Neni 79 Vrasja në rrethana cilësuese										
Neni 79/a Vrasja e funksionarëve publikë										
Neni 79/b Vrasja e punonjësve të Policisë së Shtetit										
Neni 79/c Vrasja për shkak të marrëdhënieve familjare										
Neni 80										
Neni 81 Vrasja e foshnjës										
Neni 82 Vrasja në tronditje psikike										
Neni 83 Në kapërcim mbrojtjes nevojshme										
Neni 83/a Kanosje për hakmarrje/ gjakmarrje										
Neni 83/b Nxitja për gjakmarrje										
Neni 84 Kanosja	4	1	1	1	1	5	2	2	2	2
Totali	4	1	1	1	1	5	2	2	2	2

¹ Ky tregues është totali i personave në hetim dhe të pandehur të regjistruar në organin e prokurorisë.

² Nuk janë përfshirë vrasjet e mbetura në tentativë (65 procedime regjistruar dhe 60 pandehur regjistruar).

KRIME KUNDËR JETËS SHKAKTUAR ME PAKUJDESI	2015					2016				
	Nr. Procd Regj	Nr. procd per gjykim	Nr. i pand. Regj	Nr. Pand per gjykim	Nr. Pand denuar	Nr. Procd. Regj	Nr. procd per gjykim	Nr. i pand. Regj.	Nr. Pand. Per gjykim	Nr. Pand denuar

Neni 85 Vrasja nga
pakujaesia

Totali									
---------------	--	--	--	--	--	--	--	--	--

VEPRA PENALE KUNDËR SHËNDETIT TË KRYERA ME DASHJE	2015					2016				
	Nr. Proc. Regj	Nr. Proc. për gjykim	Nr. i Pand. Regj.	Nr. Pand. Për gjykim	Nr. Pand dënuar	Nr. Proc. Regj	Nr. proc. për gjykim	Nr. i pand. Regj	Nr. Pand per gjykim	Nr. Pand dënu ar
Neni 86 Tortura										
Neni 87 Tortura me pasoja të rënda										
Neni 88 Plagosje e rëndë me dashje	4	2	2	2	2					
Neni 88/a Plagosje e rëndë në gjendje të tronditjes së fortë psiqike										
Neni 88/b Plagosje e rëndë në kapërcim të mbrojtjes										
Neni 89 Plagosje e lehtë me dashje										
Neni 89/a										
Neni 90 Dëmtime të tjera										
Totali	4	2	2	2	2					

VEPRA PENALE KUNDËR SHËNDETIT TË KRYERA NGA PAKUJDESI	2015	2016
---	------	------

armës										
Neni 105 M. Sek/ homoseksuale duke shpërdoruar detyrën										
Neni 106 M. Sek/ homoseksuale me persona në gjini ose në kujdestari										
Neni 107 M. Sek/ homoseksuale ne vende publike										
Neni 108 Vepra të turpshme										
Totali	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-

VEPRA PENALE KUNDËR LIRISË SË PERSONIT	2015					2016				
	Nr. Procd. Regj	Nr. procd per gjykim	Nr. i pand. Regj.	Nr. Pand. Per gjykim	Nr. Pand denuar	Nr. Procd Regj	Nr. procd per gjykim	Nr. i pand. Regj	Nr. Pand per gjykim	Nr. Pand denuar
Neni 109 Rrembimi ose mbajtja peng e personit										
Neni 109/a Rrembimi ose mbajtja peng e personit ne rrethana lehtesuese										
Neni 109/b Shtrengimi me ane te kanosjes ose dhunes per dhenien e pasurise	1									
Neni 109/c Zhdukja me forcë										
Neni 110 Heqja e paligjshme e lirisë										
Neni 111 Rrembimi i avioneve, anijeve dhe mjeteve te tjera										
Neni 112 Dhunimi i baneses						1				
Totali	1	-	-	-	-	1	-	-	-	-

VEPRA PENALE KUNDËR MORALIT DHE DINJITETIT	2015					2016				
	Nr. Procd Regj	Nr. proced per gjykim	Nr. i pand. Regj.	Nr. Pand. Per gjykim	Nr. Pand denu ar	Nr. Procd Regj	Nr. proced per gjykim	Nr. i pand. Regj	Nr. Pand per gjykim	Nr. Pand denu ar
Neni 113 Prostitucioni										
Neni 114 Shfrytëzimi i prostitucionit										
Neni 115 Mbajtja e lokaleve për prostitucion										
Neni 117 Pornografia										
Neni 118 Dhunimi i varreve						2				
Neni 119 Fyerja										
Neni 120 Shpifja										
Neni 121 Ndërhyrje të padrejta në jetën private										
Neni 121/a Përndjekja						1	1	1	1	1

Neni 122 Përhapja e sekreteve vetjake										
Neni 123 Pengimi ose shkelja e fshehtësisë së korrespondencës										
Totali	-	-	-	-	-		3	1	1	1

VEPRA PENALE KUNDËR FËMIJËVE, MARTESËS DHE FAMILJES	2015					2016				
	Nr. Procd Regj	Nr. proced per gjykim	Nr. i pand. Regj.	Nr. Pand. Per gjykim	Nr. Pand denuar	Nr. Procd Regj	Nr. proced per gjykim	Nr. i pand. Regj	Nr. Pand per gjykim	Nr. Pand denuar
Neni 124 Braktisja e fëmijëve të mitur										
Neni 124/b Keqtrajtimi i të miturit										
Neni 125 Mosdhënia e mjeteve për jetesë										
Neni 126 Mosnjoftimi i ndryshimit të vendbanimit						1	1	1	1	1
Neni 127 Marrja e padrejtë e fëmijës										
Neni 128 Ndërrimi i fëmijëve										
Neni 128/a Fshehja ose ndërrimi me dashje I fëmijës										
Neni 129 Shtytja e të miturve në krim										
Neni 130 Shtrëngimi ose pengimi për të bashkëjetuar ose për të zgjidhur martesë										
130/a Dhuna në familje	13	13	13	13	13	10	10	10	10	10
Totali	13	13	13	13	13	11	11	11	11	11

VEPRA PENALE KUNDËR LIRISË SË BESIMIT	2015					2016				
	Nr. Procd. Regj	Nr. proced per gjykim	Nr. i pand. Regj.	Nr. Pand. Per gjykim	Nr. Pand denuar	Nr. Procd Regj	Nr. proced per gjykim	Nr. i pand. Regj	Nr. Pand per gjykim	Nr. Pand denuar
Neni 131 Pengimi i veprimtarive të organizatave fetare										
Neni 132 Shkatërrimi ose dëmtimi i objekteve të kultit										
Neni 133 Pengimi i ceremonive fetare										
Totali	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-

VJEDHJA E PASURISË ³	2015					2016				
	Nr. Procd Regj	Nr. proced per gjykim	Nr. i pand. Regj	Nr. Pand per gjykim	Nr. Pand denuar	Nr. Procd Regj	Nr. proced per gjykim	Nr. i pand. Regj	Nr. Pand per gjykim	Nr. Pand denuar
Neni 134 Vjedhja	22	3	4	4	4	16	2	3	3	3

³ Vecuar nga ky grup dhe trajtuar me vete trafiket

Totali	14	7	7	7	7	6	5	5	5	2
---------------	-----------	----------	----------	----------	----------	----------	----------	----------	----------	----------

SHKATËRRIMI I PRONËS	2015					2016				
	Nr. Procd Regj	Nr. procd per gjykim	Nr. i pand. Regj	Nr. Pand per gjykim	Nr. Pand denuar	Nr. Procd. Regj	Nr. procd per gjykim	Nr. i pand. Regj.	Nr. Pand. Per gjykim	Nr. Pand denuar
Neni 150 Shkatërrimi i pronës	3					3				
Neni 151 Shkatërrimi i pronës me zjarr	4					4				
Neni 152 Shkatërrimi i pronës me eksploziv	1					1				
Neni 153 Shkatërrimi i pronës me përmbytje										
Neni 154 Shkatërrimi i pronës me mjete të tjera										
Neni 155 Shkatërrimi i rrugëve										
Neni 156 Shkatërrimi i rrjetit elektrik										
Neni 157 Shkatërrimi i rrjetit të ujitjes										
Neni 158	1									
Neni 159 Shkatërrimi i rrjetit të ujësjellësit	1									
Neni 160 Shkatërrimi i veprave kulturore										
Neni 161 Shkatërrimi i pronës nga pakujdesia	1									
Neni 162 Përplasja e mjeteve të transportit masiv										
Totali	11					8				

Neni 179 Ruajtja apo depozitimi i mallrave kontrabandë

Neni 179/a Mosdeklarimi në kufi i të hollave dhe i sendeve me vlerë

Neni 179/b Thyerja, heqja, zëvendësimi i shenjave të sigurisë së autoriteteve doganore

Neni 179/c Largimi i mallrave nga zonat doganore pa paguar detyrimet

Neni 179/c Largimi i mallrave nga zonat doganore pa paguar detyrimet

Neni 179/ç Kontrabanda e kapitenit, pilotit ose ekuipazhit

Totali

2

-

-

-

-

-

-

-

-

-

VEPRA PENALE NË LIDHJE ME TAKSAT E TATIMET

2015

2016

	Nr. Proecd Regj	Nr. proced per gjykim	Nr. i pand. Regj.	Nr. Pand. Per gjykim	Nr. Pand denuar	Nr. Proecd Regj	Nr. proced per gjykim	Nr. i pand. Regj	Nr. Pand per gjykim	Nr. Pand denuar
Neni 180 Fshehja e të ardhurave	3	1	1	1	1					
Neni 180/a										
Neni 181 Mospagimi i taksave dhe tatimeve	1									
Neni 181/a Moskryerja e detyrave nga organet tatimore										
Neni 182 Ndryshimi në aparatet matëse										
Neni 182/a										
Totali	4	1	1	1	1	-	-	-	-	-

KRIME KUNDËR AUTORITETIT TË SHETËTIT	2015					2016				
	Nr. Procd Regj	Nr. procd per gjykim	Nr. i pand. Regj.	Nr. Pand. Per gjykim	Nr. Pand denuar	Nr. Procd Regj	Nr. proced per gjykim	Nr. i pand. Regj	Nr. Pand per gjykim	Nr. Pand denuar
Neni 235 Kundërshtimi i punonjësit që kryen një detyrë shtetërore ose një shërbim publik										
Neni 236 Kundërshtimi i punonjësit të policisë së rendit publik						1				
Neni 237 Goditjet për shkak të detyrës	2	2	2	2	2	1	1	1	1	1
Neni 238 Kanosja për shkak të detyrës	3	2	2	2	2	2				
Neni 242 Mosbindja ndaj urdhrit të punonjësit të policisë së rendit publik	5	5	5	5	5	2	2	2	2	2
Neni 243 Goditjet ndaj pjesëtarëve të familjes së personit që kryen një detyrë shtetërore										
Neni 246 Përvetësimi i titullit apo i detyrës shtetërore										
Neni 246/a Ushtrimi i profesionit të ekspertit kontabël dhe i shoqërisë audituese pa qenë i regjistruar										
Neni 247 Mbajtja pa të drejtë e uniformës										
Totali	10	9	9	9	9	6	3	3	3	3

VEPRA PENALE KUNDËR VEPRIMTARISË SHETËTËRORE TË KRYERA NGA PUNONJËSIT SHETËTËRORE OSE NË SHËRBIM PUBLIK	2015					2016				
	Nr. Proc d. Regj	Nr. proced per gjykim	Nr. i pand. Regj.	Nr. Pand d. Per gjykim	Nr. Pand denuar	Nr. Proce d Regj	Nr. proced per gjykim	Nr. i pand. Regj	Nr. Pand per gjykim	Nr. Pand denuar
Neni 248 Shpërdorim detyre	9	1	2	2	2	6	5	9	9	1

Neni 320/a Mosekzekutimi pa shkaqe të përligjura i vendimit të gjykatës									
Neni 321 Veprime në kundërshtim me vendimin e gjykatës									
Neni 322 Prishja e vulave dhe shenjave									
Neni 323 Largimi i të burgosurit nga vendi i qëndrimit									
Neni 324 Dhënia ndihmë një të burgosuri për largim									
Neni 324/a Futja ose mbajtja e sendeve të ndaluara në institucionin e ekzekutimit të vendimeve me burgim									
Totali	3	3	5	5	5	2	2	2	2

Neni 312 Korrupsioni aktiv i dëshmitarit,ekspertit ose përkthyesit					
Neni 319 Korrupsion aktiv i gjyqtarit, prokurorit dhe i funksionarëve të tjerë të drejtësisë					
Neni 319/a Korrupsioni aktiv i gjyqtarit ose i zyrtarit të gjykatave ndërkombëtare					
Neni 319/b Korrupsioni aktiv i arbitrit vendas dhe të huaj					
Neni 319/c Korrupsioni aktiv i anëtarëve të jurive gjyqësore të huaja					
Neni 319/ç Korrupsion pasiv i gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë					
Neni 319/d Korrupsioni pasiv i gjyqtarit ose i zyrtarit të gjykatave ndërkombëtare					
Neni 319/dh Korrupsioni pasiv i arbitrit vendas dhe të huaj					
Neni 319/e Korrupsioni pasiv i anëtarëve të jurive gjyqësore të huaja					
Neni 328 Dhenia e shperblimeve dhe e premtimeve	2015	1	2016		
Totali		1	-	-	-

PRODHIMI DHE KULTIVIMI I NARKOTIKËVE	2015					2016				
	Nr. Procd Regj	Nr. procd per gjakim	Nr. i pand. Regj.	Nr. Pand. Per gjakim	Nr. Pand denuar	Nr. Procd Regj	Nr. procd per gjakim	Nr. i pand. Regj	Nr. Pand per gjakim	Nr. Pand denuar
Neni 283 Prodhimi dhe shitja e narkotikëve	1	1	1	1	1	5	2	2	2	1
Neni 284 Kultivimi i bimëve narkotike	46	10	10	10	10	86	10	15	15	11
Neni 284/a Organizimi dhe drejtimi i organizatave kriminale										
Neni 284/c Prodhimi dhe fabrikimi i lendeve narkotike dhe psikotrope										
Neni 285 Mbajtja, prodhimi dhe transportimi i sustancave kimike										
Totali	47	11	11	11	11	91	12	17	17	12

PROKURORIA E RRETHIT GJYQESOR PUKE
VEPRAT PENALE TE KRYERA ME DASHJE KUNDER SHENDETIT

V.P. K/shëndetit me dashje	Nr. Procd . Regj	2014				2015				Nr. Pandenuar
		Nr. proc d per gjykim	Nr. i pan d. Regj .	Nr. Pan d. Per gjy kim	Nr. Pan d den uar	Nr. Proc d Re gj	Nr. proc d per gjykim	Nr. i pan d. Reg j	Nr. Pan d per gjykim	
Neni 86 Tortura	Shifra baraz me kolonen nr 15	Kolona nr 70	Shuma e kolonave 16+17	Kolona 71	Shifra baraz me kolonat 112+120					
Neni 87 Tortura me pasoja të rënda										
Neni 88 Plagosje e rëndë						4	2	2	2	2
Neni 88/a Plagosje e rëndë tronditje psikike										
Neni 88/b P.R. në kapërcim të mbrojtjes										
Neni 89 Plagosje e lehtë me dashje		1	1	1	1	2				
Neni 89/a										
Neni 90 Dëmtime të tjera										
Totali		1	1	1	1	6	2	2	2	2



[Redacted]

[Redacted]

[Redacted]

[Redacted]

[Redacted]

